



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr. 6611 Prot

Gjirokastër më 7 : 7:2025

Lënda: Procesverbal i mbledhjes së dates 03.07.2025

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak po ju vendosim në dispozicion procesverbalin e mbledhjes së datës. 03.07.2025

PROCESVERBAL

I mbajtur sot në 03.07.2025 në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Gjirokastër. Mbledhja po zhvillohet te mediateka pranë Universitetit “Eqrem Çabej”. Mbledhja fillon në orën 12:09.

Marrin pjesë në mbledhje 19 anëtarë. Mungojnë në mbledhje: Aliko, Shehaj, Kristidhi, Feruni, Pandos, Peta, Leskaj, Rova, Kore, Sufati, Novi,,Basha, Hilaj.

Futen online në mbledhje znj Isaraj Z. Feruni

Hapet mbledhja nga Znj.Shehaj.Është kuorumi për fillimin e mbledhjes.19 anëtarë

Znj. Shehaj paraqet rendin e ditës.

1. Miratim i procesverbalit të mbledhjes së datës 30.05.2025

2. P/V“Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin 01.06.2025-30.06. 2025”.

P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin 01.06-30.06 2025.

4.P/Vendim “Për miratimin e Buxhetit Faktik 2024”

5.P/Vendim “Për shprehjen e pëlqimit për realizimin e shpronësimeve në zbatim të projektit “Rikonstruksion i Tregut të Frutave dhe Perimeve”.

6.Raporti i Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit për periudhën janar -prill 2025.

8.Trajtimi i kërkesave të qytetarëve

Znj.Shehaj ; Lexon rendin e dites.

Z. Brahimi: kam një pyetje , kam dy mbledhje që kërkoj raportim nga Policia Bashkiake, pse nuk po vjen ky raport?Ne nuk jemi këtu vetëm për materialet që sillni ju, por edhe për ato që kërkojmë ne.

Znj. Koko: Ju informoj se janë bërë ndryshime ne stafin drejtues të Policisë Bashkiake dhe në mbledhjen e ardhshme do të keni një raport të detajuar për punët , detyrat dhe përgjegjësitë e saj.Pse nuk i ktheni përgjigje dhe zgjidhje kërkesës së daktreshë Liljanës?

Z. Llogo:Nuk është detyra jonë kjo. Ekzekutivi i sqaron dhe ju kthen vetë përgjigje.

Hidhet në votë rendi i ditës dhe miratohet me 18 vota pro.

Hidhen në votë dhe miratohet me 19 vota pro procesverbali i mbledhjes së datës 30.05.2025.

Hidhen në votë dhe miratohen me 19 vota pro 2 p/vendimet e ndihmës ekonomike për muajin Qershor 2025.

P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin 01-30.06. 2025”.

P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin .01-30.06.2025”.

Znj. Shehaj: Kanë kaluar në Komisionin e Financave pikat 4 dhe 5.

Trajtohet pika 5

Sqaron znj Koko: Ky raport është detyrim ligjor dhe bazohet në Raportin 12 mujor të zbatimit të buxhetit për vitin 2024. Rekomandimet e Ministrisë së Financave dhe pasqyrat financiare. Mungon raporti i KLSH-së pasi është mbyllur para së KLSH-ja të jepte rekomandimet, por do t'i shtohen dhe do të jenë pjesë e raportiti për 2025.

Gjatë vitit 2024 janë realizuar 93% të të ardhurave dhe 74% investimet. Performancë më të mirë kanë patur shërbimet sociale,arsimi, shërbimet mbështetëse.

Arsyeja e mosrealizimeve është se disa nga fondet e projekteve janë fituar në fund të vitit dhe zbatimi i tyre i takon vitit 2025, pra janë pjesë e raportit 4 mujor për 2025.

Hidhet në votë pika 4 “Për miratimin e Buxhetit Faktik 2024”, dhe miratohet me 18 vota pro.

Kalohet te pika 5 e rendit të ditës. Ka kaluar në komision.

Z. Nebiaj sqaron për këshilltarët nevojën e këtij shpronësimi me vlerë rreth 4.500.000 lekë me qëllim zbatimin e projektit të rikostruksionit të tregut të frutave dhe perimeve.

Z.Brahimi:Materiali është i qartë.

Hidhet në votë dhe miratohet me 17 vota pro dhe një abstenim.znj. Cacaj “

Kalohet te pika 6. .Raporti i Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit për periudhën janar -prill 2025.

Raporti është informues.

Z. Brahimi: Në lidhje me Njësitë Administrative; A sjellin të ardhura, a shkojnë në punë, a ka rezultat puna e tyre?

Znj. Koko: Po ka të ardhura nga njësitë ,por shifrat mund të sillen nga Drejtoria e të Ardhurave, kurse për paraqitjen në punë, zbatimin e orarit dhe kryerjen e detyrave çdo gjë është konform rregullores.

Nga këshilltarët në fund të mbledhjes u paraqitën këto kërkesa:

Z. Brahimi: Të ndërhyet në rrugën e fshatit Kardhiq, rruga është e bllokuar me ferra driza. Të merren masa. Të ndërhyet në qendër të fshatit. varrezat e fshatit Plesat të rrethohen

Z. Drasa; Shpreh shqetësimin e banorëve të 7 Kronjtë për investimin e kryer nga FSHZH ku sinjalistika është e çuditshme dhe pengon banorët. Për një rrugë 30m i biem vërdallë gjithë lagjes, kur në të gjithë atë pellg 7 makina janë të banorëve rezident. Po e shtroj këtu, ia kemi drejtuar kërkesën edhe investitorit, edhe bashkisë.

ZNJ. Cacaj: Te memoriali i qytetit ku janë figurat e shquara të qytetit janë vetëm me mbiemra. A mund të ketë më shumë informacion, qoftë edhe me një barkod që skanohet dhe jep informacion, sepse kam parë që turistët i shohin po s kanë ku ta marrin informacionin.

Situata e qenve endacakë është shqetësuese, A ka ndonjë plan për trajtimin e tyre?

Z. Nebiaj: E njohim situatën dhe jemi duke planifikuar një vend për mbajtjen e tyre dhe grumbullimin në një strehë.

Sqaron znj. Koko për Materialin që këshilltarët e kanë në emalin e tyre në lidhje me miratimin e Dokumentit të parë të PBA 2026-2028 i cili duhej miratuar në datë 30.06 sipas ligjit, por për shkak të ardhjes së rekomandimeve me vonesë nga MF po na shtyhen afatet dhe ky material duhet miratuar brenda muajti korrik 2025.

Mbyllet mbledhja nga znj Shehaj në orën 12.38 min .

SEKRETAR I KËSHILLIT

Etleva Yzo



KRYETAR I KËSHILLIT

Merita Isaraj

